

LIGJ
Nr.10 003, datë 6.10.2008

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Neni 24 riformulohet si më poshtë:

“Neni 24
Organizatat jofitimprurëse

Furnizimi i bërë nga një organizatë jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar është një furnizim i përjashtuar nëse është:

a) furnizim shërbimesh nga organizata fetare apo filozofike, me qëllim mirëqenien shpirtërore;

b) furnizim mallrash e shërbimesh nga organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik dhe që çmimet e mallrave dhe shërbimeve që ato furnizojnë janë dukshëm më të ulëta se çmimet e tregut.

Statusi i organizatave jofitimprurëse për përfitim publik jepet me autorizim nga Ministri i Financave, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 26, pika 2.1. ndryshohet si më poshtë:

“2.1. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në 12 muaj. Për rastet kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më i gjatë se 12 muaj, Ministri i Financave ka autoritetin ta zgjasë afatin e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, në varësi të ciklit të zhvillimit të investimit të parashikuar në marrëveshje apo kontratë. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë, në çastin e importit.

Skema e re e shtyrjes së pagesës së TVSH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret dhe procedurat, që do të ndiqen për shtyrjen e TVSH-së, në rastin kur zgjatja e ciklit të investimit dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më e gjatë se 12 muaj, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 26/1 bëhen këto ndryshime e shitesa:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat, brenda vendit, është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji;”.

2. Pas shkronjës “e” shtohen shkronjat “ë” dhe “f” me këtë përmbajtje:

“ë) importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

f) importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.”.

Neni 4

Në nenin 55, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, të gjitha detyrimet dhe penalitetet për to paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5917, datë 22.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**